REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 978/20
Datë/Datum. 04.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të Raportit*	*Nr. i lëndës:*
Hysni Muhadri	24.11.2020	04.12.2020	978/20

NENI 105 i LPP-së, BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:19.11.2020, OE **"ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: 978/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rregullimi i rrethojës së sigurisë për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë", me nr te prok: 214-20-7472-5-2-1, të** iniciuar nga **(AK)** - Ministria e Punëve të Brendshme **(MPB)**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, punë, vlera e parashikuar e kontratës: s: 200, 605,12 €.

Data e njoftimit për kontratë.....11.11.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....16.11.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:.....19.11.2020.

Nuk është e përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

PRETENDIMET ANKIMORE DHE DISPOZITAT E SHKELURA

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë, janë:

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;

Neni 28 – Specifikimet teknike;

Neni 51 – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes;

Neni 70 – Standardet për Sigurimin e Cilësisë;

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;

Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve;

Neni 18.9 – RRUOPP-së;

Neni 26.4 – RRUOPP-së;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Nenin 108/A i LPP-së - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Me datën 16.11.2020 kemi bere kërkesë për RI-SHQYRTIM pran AK-s, duke kërkuar qe te ri-shqyrtojnë kërkesat dhe kushtet e vendosura ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit, ku nuk kemi marre përgjigje deri me tani.

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelej te nenit 7 pasi qe me kërkesat **(9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale)** ka kufizuar konkurrencën ose ma mire me thënë qe e ka përshtat për kompani te caktuar sepse kërkesat e kërkuara ne njoftim për kontrate dhe ne DT, janë aq specifike sa qe vetëm personi qe i ka kërkuar nga ana e AK-s dhe OE qe i plotësoni këto kërkesa nga një bashkëpunim paraprak dhe koordinim te plote me njeri tjetrin kan dite ti rendisin ne këtë mënyrë, sepse shumica e këtyre kërkesave as nuk kane te bëjnë me projektin ne fjale fare, mirëpo janë parapare qe te kufizojnë konkurrencën ne maksimumin e mundshëm, **(ma mire kishte me qen qe te shkruhej edhe një vërejtje ne njoftimin për kontrate qe lejohet vetëm "X" OE te konkurroj)**.

Me poshtë po i renditim kërkesat qe janë diskriminuese dhe e kufizojnë konkurrencën, kërkesat dhe dëshmitë si me poshtë:

Kapaciteti teknik dhe professional:

Pika

3. Së paku një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me kualifikim diplome si International Welding Specialist (IWS). Inxhinieri duhet te ketë përvojë pune ne lëmin e saldimeve se paku 3 vite. Diploma e IWS duhet te jete e akredituar ne International Welding insitute (IIW)- Instituti ndërkombëtar i Saldimit.

6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një ekspert për ITIL v3 EXPERT.

7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një Ekspert për Sigurimin e Cilësisë.

8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion Dy (2) teknik te certifikuar nga prodhuesi për CCTV.

10. Operatori ekonomik, për pozicionet e CCTV Sistemi i kamerave, duhet të ofroj MAF nga prodhuesi.

17. Kamion me vinç dhe platformë (korpe) deri 30m'

Dëshmia e kërkuar dokumentare

3. Diploma e noterizuar nga origjinali. - diploma e IWS e noterizuar nga origjinali; -CV; - Kontrata-marrëveshja e punës valide me punëdhënësin-kopje, -referencat qe dëshmojnë për punët e kryera dhe përvojën ne projekte te natyrës se ngjashme-kopje.

6. Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për ITIL v3 EXPERT - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje

7. 6. Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për ITIL v3 EXPERT - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje

8. Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për CCTV - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje.

10. MAF-i (Manufacturer Authorisation Form direct nga prodhuesi të skanohet nga Origjinal) për pozicionet Sistemi i kamerave.

17. Kopjen e librezës qe e ka ne pronësi (ose kontrate mbi shfrytëzimin e pajisjeve – me qera me ndonjë operator ekonomik- kontrata e noterizuar) me dëshmitë e pronësisë.

Ne vazhdim secilën do te elaborojmë qe janë te pa nevojshme dhe ne kundërshtim te plote me LPP:

Kërkesa 3.

3. Së paku një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me kualifikim diplome si International Welding Specialist (IWS). Inxhinieri duhet te ketë përvojë pune ne lëmin e saldimeve se paku 3 vite. Diploma e IWS duhet te jete e akredituar ne International Welding insitute (IIW)- Instituti ndërkombëtar i Saldimit.

- *Ne Universitetin e Prishtinës dhe as ne universitetet private ne Kosove nuk ka asnjë drejtim me kualifikim diplome **International Welding Specialist (IWS)**, për me shumë as Republika e Kosovës nuk është anëtare ne këtë institut ku ka gjithsejt 53 shtete anëtare.*

*Kjo kërkesë nuk përkon me sigurimin e cilësisë ne realizimin e projektit ne fjale, formimi i rrethojës metalike te kërkuar ne këtë projekt është njëra nga saldimet me te thjeshta te mundshme ne ndërtimtari, për kontrollin e cilësisë se saldimeve ne Republikën e Kosovës është kompetent **Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike** pran **UP-s.***

- ***Kjo kërkesë duhet te hiqet qe te jet konkurrenca e lire dhe fer.***



FOTO 1. Lista e shteteve anëtare ne Evropë[1]

Kërkesa 6.

6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një ekspert për ITIL v3 EXPERT.

- *Edhe kjo kërkesë sikurse ajo me pare është vendosur për kufizimin e konkurrencës pasi qe është shume specifike. Kjo kërkesë nuk ka te bej fare me projektin dhe siç edhe e cekem me lart këto kërkesa janë vendosur ne bashkëpunim te ngushte me personin përgjegjës pran AK-s dhe OE qe posedon këto certifikata.*

  - ***Kjo kërkesë duhet te hiqet qe te jet konkurrenca e lire dhe fer.***

Kërkesa 7.

7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një Ekspert për Sigurimin e Cilësisë.

- *Kjo kërkesë mendojmë se qëllimisht është kërkua dëshmia dokumentare e pikës 6, pasi qe vetëm kështu e kufizon konkurrencën, ka shume metoda me te thjeshta qe e garantojnë dhe e sigurojnë cilesin e ekzekutimit te kontratës, sepse keto AK-ja i ka vendosur vetëm sa te diskriminoj disa OE e te favorizoj nje OE tjeter .*

  - ***Kjo kërkesë duhet te hiqet qe te jet konkurrenca e lire dhe fer.***

Kërkesa 8.

8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion Dy (2) teknik te certifikuar nga prodhuesi për CCTV.

- *Edhe kjo kërkesë sikurse ato me pare është vendosur për kufizimin e konkurrencës pasi qe është shume specifike, kjo ndërlidhet edhe me emrin qe është vendosur prodhuesi i kamerave ne paramasë ku është favorizuar direkt prodhuesi ne fjale, duke ju përmendur emri ne kundërshtim me nenin 28. LPP-s,*

  - ***Kjo kërkesë duhet te hiqet qe te jet konkurrenca e lire dhe fer.***

Kërkesa 10.

10. Operatori ekonomik, për pozicionet e CCTV Sistemi i kamerave, duhet të ofroj MAF nga prodhuesi.

- *Edhe kjo kërkesë sikurse ato me pare është vendosur për kufizimin e konkurrencës pasi qe është shume specifike, kjo ndërlidhet edhe me kërkesën nr. 8, si dhe emrin qe është vendosur prodhuesi i kamerave ne paramasë ku është favorizuar direkt prodhuesi ne fjale, duke ju përmendur emri ne kundërshtim me nenin 28. LPP-s, MAF mund te sigurojnë vetëm shitësit e autorizuar nga prodhuesi i cekur ne paramase (Acti), ku ne këtë rast AK-ja ka bere shkelje flagrante te LPP-s pasi qe qëllimshëm e ka kufizuar konkurrencën dhe ka diskriminuar mbi 95% te OE- tjerë (apo me mire me thënë te gjithë përveç njërit OE)*

  - ***Kjo kërkesë duhet te hiqet qe te jet konkurrenca e lire dhe fer.***

Kërkesa 17.

17. Kamion me vinç dhe platformë (korpe) deri 30m"

Vendosja e këtij kushti ne këtë projekt është jashtë çdo logjike dhe ne te njëjtën kohe jo profesionale, o tha se është projekti për ndërtimin e ndonjë salle te sportit apo çfarë.
Nga skicat e bashkangjitura kemi te bëjmë me një rrethoje metalike qe ka lartësinë maksimale h=3 m, dhe te kërkosh një vinç me gjatësi te krahut 30 m, kjo është PA KOMENT!!!!!!!!!!,

- ***Kjo kërkesë duhet te hiqet qe te jet konkurrenca e lire dhe fer.***

Te gjitha këto qe cekem me larte e vërtetojnë se AK-ja ka bere kufizimin e konkurrencës dhe ate qëllimshëm qe te favorizoj një OE te caktuar dhe te diskriminoj te tjerët.

Neni 28 i LPP-së - Specifikimet teknike (pikat 2,3,4,5)

AK-ja ka bere shkelje te këtij neni pasi qe ne kundërshtim me nenin 28 pikat 2,3,4,5 ka përpiluar specifika dhe ka kërkuar standarde diskriminuese edhe pse një gjë e tille është e ndaluar me nenin ne fjalë, (citojmë pikat 2, 3, 4, 5 te nenit 28 te LPP-s)

1. *Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.*

2. *Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera.*

3. *Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.*

4. *Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohet nga sipas paragrafit 4. nuk ekziston, ose nëse përdorimi i tij kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashmë janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës ose (ii) një miratimi teknik të Kosovës.*

Neni 51 i LPP-së - Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

AK-ja ka vepruar ne kundërshtim ne nenin 51, pike 1, 2 dhe 3 ku ka kërkesat qe ka parashtruar janë jo relevante për projektin ne fjale.

1. Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator I interesuar ekonomik duhet ti përmbushë për tu konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhënien e një kontrate; ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara ose procedurave konkurruese me negociata , për të pranuar një ftesë për tenderim. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. **Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji.**

3. Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Neni 70 i LPP-së - Standardet për Sigurimin e Cilësisë

AK-ja ka vepruar ne kundërshtim ne nenin 71,
Citojmë paragrafin e nenint 71

Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t'u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe (ii) të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet e certifikimit. Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së. Autoriteti kontraktues po ashtu pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara.

Neni 69 i LPP-së- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale (pika 6 - 6.1 -6.5 -6.6)

AK-ja ne kundërshtim me nenin 69 ka kërkuar qe te plotësohen nje ser kërkesash sipas DT-s **(9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale)**, te cilat janë ne kundërshtim me nenin 69 pikat 6.1, 6.5, 6.6, si dhe me praktikat e mira.

6. Në procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e aktiviteteve të tilla; në veçanti, autoriteti kontraktues mund të kërkojë të dhëna përkitazi me:

6.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projekteve të punës ose për realizimin e aktiviteteve ndërtimore;

6.2. listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar treviçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, autoriteti kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me autoritetin

publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues;

6.3. raportin për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e projektit të punëve ose përmbushjen e aktiviteteve ndërtimore;

6.4. raportin për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara;

6.5. raportin për teknikët ose të njësitë teknike në të cilët mund të thirret kontraktuesi për zbatimin e projektit të punëve ose realizimin e aktiviteteve ndërtimore, pavarësisht se a i takojnë ose nuk i takojnë operatorit ekonomik; dhe/ose

6.6. informacion tjetër përkatës dhe relevant.

Neni 18.16 RRUOP-se –Është e ndaluar përgatitja e Dosjes së Tenderit në një mënyrë që favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë Operatorëve Ekonomik potencial

Neni 26.8 RRUOP-se
Shih tabelën e RRUOPP nga faqe (53-61)

Nga te gjitha te cekurat me larte, konstatojmë se kërkesat ne njoftim për kontrate dhe ne dosje te tenderit (DT) jenë ne kundërshtim te plote me LPP-n dhe RRUOPP-n dhe se këto kërkesa e kufizojnë konkurrencën e lire dhe fer për projektin ne fjale si dhe favorizojnë fuqishëm një OE tjetër.

Pas përshkrimit të fakteve të lartshënuara dhe gjendjes faktike, nga Paneli Shqyrtues në OSHP kërkojmë qe te urdhëroj AK-n ta beje ndryshimin e këtyre kërkesave dhe te përpiloj kërkesa relevante për projektin ne fjale duke mos kufizuar konkurrencën e lire dhe te sinqert si dhe duke favorizuar OE te caktuar, kërkojmë PSH i OSHPS te urdhëroj AK-n qe te heq kushte dhe kërkesat qe kemi cekur me lart, dhe te bej ndryshim plotësimet e nevojshme ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate.

FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET – KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***
III.2.4) Kapaciteti ekonomike dhe financiare:	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 3. Së paku një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me kualifikim diplome si International Ëelding Specialist (IËS). Inxhinieri duhet te ketë përvojë pune ne lëmin e saldimeve se paku 3 vite. Diploma e IËS duhet te jete e akredituar ne International Ëelding insitute (IIË)- Instituti ndërkombëtar i Saldimit. 6. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një ekspert për ITIL v3 EXPERT. 7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një Ekspert për Sigurimin e Cilësisë.	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** *3. Diploma e noterizuar nga origjinali, - diploma e IËS e noterizuar nga origjinali; - CV; -Kontrata-marrëveshja e punës valide me punëdhënësin-kopje, -referencat qe dëshmojnë për punët e kryera dhe përvojën ne projekte te natyrës se ngjashme-kopje.* *6. Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për ITIL v3 EXPERT - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje.* *8. Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për CCTV - kopje -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për*

8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion Dy (2) teknik te certifikuar nga prodhuesi për CCTV. 10. Operatori ekonomik,për pozicionet e CCTV Sistemi i kamerave, duhet të ofroj MAF nga prodhuesi. 17. Kamion me vinç dhe platformë (korpe) deri 30m.	*këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje.* *10. MAF-i (Manufacturer Authorisation Form direct nga prodhuesi të skanohet nga Origjinal) për pozicionet Sistemi i kamerave.* *17. Kopjen e librezës qe e ka ne pronësi (ose kontrate mbi shfrytëzimin e pajisjeve – me qera me ndonjë operator ekonomik- kontrata e noterizuar) me dëshmitë e pronësisë.*

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS SË OE "ASTRAPLAN" SH.P.K –Prishtinë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: *"Së paku një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master me kualifikim diplome si International Welding Specialist (IWS). Inxhinieri duhet te ketë përvojë pune ne lëmin e saldimeve se paku 3 vite. Diploma e IWS duhet te jete e akredituar ne International Welding insitute (IIW)- Instituti ndërkombëtar i Saldimit".*

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: *"Diploma e noterizuar nga origjinali, - diploma e IWS e noterizuar nga origjinali; - CV; -Kontrata-marrëveshja e punës valide me punëdhënësin-kopje, -referencat qe dëshmojnë për punët e kryera dhe përvojën ne projekte te natyrës se ngjashme-kopje".*

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë si dhe aktivitetin e prokurimit i cili aktivitet ka të bëjë me Rregullim të rrethojes, eksperti shqyrtues sqaron se duhet të HIQET pjesa: ***"Me kualifikim diplome si International Welding Specialist (IËS) dhe Diploma e IWS duhet të jete e akredituar ne International Welding insitute (IIW)- Instituti ndërkombëtar i Saldimit",*** *dhe të MBETET* pjesa: ***"Së paku një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë,*** *edhe të kërkohet si kriter shtesë një* ***SALDUES.*** *Ky ndyshim duhet të bëhet për të pasur sa më shumë konkurrencë dhe të ju jepet mundësi që të ofertojnë edhe kompani të reja, si dhe duke pasur parasysh që nuk kërkohen rrethoja speciale, mendoj se nuk ka nevoj që saldues me certifikim nërkombëtarë. Gjithashtu të përmisohet pjesa tek dëshmit dokumentare, të hiqet pjesa e dëshmive të kërkuara për kualifikimin* ***"International Ëelding Specialist (IËS)".***

Përgjigje në Pretendimi nr. 2
Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: *"Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një ekspert për ITIL v3 EXPERT".*

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: *"Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për ITIL v3 EXPERT - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje".*

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, natyrën e aktivityetit të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se kualifikimit për ITIL v3 EXPERT, mendoj se është një certifikim especifik, nga një shtet i caktuar, andaj duhet të jetë certiikimi për ITIL v3 EXPERT ose certifikime ekujvalent.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3
Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: *"Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një Ekspert për Sigurimin e Cilësisë".*

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: *"Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion një ekspert për ITIL v3 EXPERT - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje", e njëjta dëshmi me dëshmin e kërkuar tek kërkesa nr.6, ku mendoj që është bërë ndonjë gabim.*

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, natyrën e aktivitetit të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se mund të mbetet Eksperti për Sigurimin e Cilësisë, mrëpo të elaborohet (sqarohet) çfar fushe është eksperti në fjalë, çfar kualifikimi të ketë. Si dhe të permisohet pjesa tek dëshmit dokumentare sepse është e njëjtë me dëshmit e kërkuara për kërkesën me nr. 6.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4
Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: *"Operatori Ekonomik duhet të paraqesë së ka në dispozicion Dy (2) teknik të certifikuar nga prodhuesi për CCTV".*

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: *"Certifikatat - dëshminë e kualifikimit për CCTV - kopje , -CV; - kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt valide me punëdhënësin-Kopje.*

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se akronimi CCTV, nuk është emër i ndonjë prodhuesit, por certifikim pwr CCTV.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5
Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: *"Operatori ekonomik, për pozicionet e CCTV Sistemi i kamerave, duhet të ofroj MAF nga prodhuesi".*

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: *"MAF-i (Manufacturer Authorisation Form direct nga*

prodhuesi të skanohet nga Origjinal) për pozicionet Sistemi i kamerave".

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrues sqaron se përveq kërkesës që për pozicionet e CCTV Sistemi i kamerave, duhet të ofroj MAF nga prodhuesi, duhet të jetë edhe nga Distributori, po ashtu të përmisohet e dhe pjesa të dëshmit dokumentare.

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është kërkuar: *"Kamion me vinç dhe platformë (korpe) deri 30m".*

Tek Dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar: *"Kopjen e librezës qe e ka ne pronësi (ose kontrate mbi shfrytëzimin e pajisjeve – me qera me ndonjë operator ekonomik- kontrata e noterizuar) me dëshmitë e pronësisë".*

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa ***"Kamion me vinç dhe platformë (korpe) deri 30m",*** NUK është kërkesë diskriminuese (kufizuese), sepse me sa kuptojë une Kamion me vinç dhe platformë (korpe), mund të jetë 1m min deri në 30m maxi, pra maksimumi është 30m.

Eksperti shqyrtues sqaron se në nenin 18.9 të RRUOPP-së, thuhet: "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë EO-ve".

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të bëhen ndryshimet e duhura, të njoftohen palët me ndryshimet dhe të vazhdohet më tutje me aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – "ASTRAPLAN" SH.P.K